



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 1177/2022  
Data: 16.02.2022

## PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e parë -I- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 27.01.2022 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: z.**Mehmet Ballazhi** (Kryetar i Komunës, **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Kimete Kuka -Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Arsim Dernjani** (Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencë), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh për Administratë), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Bajrush Laçi** (Shef i Zyrës Ligjore), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Informim). Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Informatë rreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.
3. Plani i punës së kryetarit të komunës për vitin 2022.
4. Propozim vendimi për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2021-2022.
5. Caktimi i kriterëve për shpalljen e konkursit për tri komitetet konsultative të komunës së Hanit të Elezit.
6. Themelimi i panelit (ad hok) përzgjedhës të anëtarëve të komiteteve konsultative në komunën e Hanit të Elezit.
7. Informatë mbi veprimtarit e subjekteve afariste për vitin 2021.
8. Formimi i komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale për mbeturina.
9. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- për pika e rendit të punës hapi diskutimin,

**Qamush Brava** thekson:- para se me filluar mbledhjen në fillim vërejtje kam te respektimi i masave për shkak se nga kuvendi është kërkuar me u mbajtur distanca dhe është në rregull, ndërsa ekzekutivi i komunës nuk e ka. Ju e dini se si i kemi respektuar masat dhe nëse respektohen të respektohen në dy anët.

**Kryesuesi** thekson:- ju e dini se sa është hapësira dhe besoj që jemi munduar me i respektuar dhe besoj që këtu të gjithë drejtorët dhe anëtarët e kuvendit të komunës janë të vaksinuar që besoj që kjo ka mundur të jetë arsyeja. A keni edhe ndonjë diskutim për rendin e punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

## 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

## 2. Informatë rreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin

**Kimete Kuka -Hasallari** thekson:- si në gjithë Kosovën po ashtu edhe në komunën tonë vërehet një rritje e dukshme e pacienteve me covid-19, krahas gripit sezonal në ditët e fundit është rritur edhe numri i pacientëve me covid, nga fillimi i muajit Janar deri me datë 26.01.2022 numri total i kontrolleve mjekësore është 802 nga të cilat kontrolla 50 raste rezultojnë me covid-19 kryesisht moshë e re dhe të pa vaksinuar as me njërën dozë të vaksinës. Nga këto 50 raste 6 janë të shëruar dhe një i vdekur. Gjatë këtij muaji kemi mbajtur takim me Shtabin Emergjent dhe Task forcën Komunale për të ndërmarr masat e nevojshme në parandalimin e kësaj Pandemie. Vlen të ceket se tash e tutje vendimet për izolim dhe vendimet për lirim nga izolimi janë në kompetencë të Agjensionit Ushqimit dhe Veterinarisë për shkak se të gjithë inspektorët sanitar komunal kanë kaluar në kuadër të këtij Agjensionit me zyre regjionale ne Ferizaj. Vaksinimi në komunën tonë ka filluar me datë 08.04.2021 dhe është në proces e sipër ku deri me 26.01.2022 janë dhënë 9317 doza të administruara dhe prej tyre me dozën e parë 4756, me dozën e dytë 4262, me dozë e tretë 299, nxënës deri tani janë vaksinuar vetëm 123 .

**Zaim Bela** thekson:- si do të trajtohen rastet për shkak se u shpjegua se tash vetëm shtatë ditë janë në karantinë . Ata të cilët janë të vaksinuar a duhet me nejtë të distancuar prej familjarëve.

**Refet Kalaisi** thekson:- pse nuk bëhen analizat në QKMF. A dihet sa është numri i banorëve të cilët janë të pa vaksinuar , afërsisht a keni ndonjë statistikë.

**Sherif Berisha** thekson:- personat të cilët janë me covid po dalin e nuk po e respektojnë vendimin dhe kush duhet të merret me këta persona. Do të ishte mirë me marr masa ndaj këtyre personave.

**Kimete Kuka -Hasallari** thekson:- personat të cilët dalin pozitiv janë të detyruar të qëndrojnë të izoluar dhjetë ditë , mirëpo nëse gjendja e tyre shëndetësore është e mirë mund të lirohen edhe brenda shtatë dite duke bërë testin serologjikë në ditën e gjashtë dhe ditën e shtatë , e nëse rezultojnë të dy testet negative lirohen nga vetë izolimi. Sa i përket laboratorit laborantja ka rezultuar pozitivë dhe si mundësi për mos me mbetur keq qytetarët kemi diskutuar me stafin e QKMF-së dhe për analizë të testeve e kemi përcaktuar krye motrën për me i kryer testet deri sa të kthehet laborantja. Vendimet për izolim dhe vendimet për vetë izolim i lëshon Agjensionit i Ushqimit dhe Veterinarisë në zyrën regjionale në Ferizaj. Takim kemi pasur me drejtoreshën e institutit të shëndetit publik në Ferizaj që ta kemi një autorizim për me i lëshuar vendimet sepse do të ishte më e menaxhueshme situata por nuk na i ka lejuar. Për personat të cilët janë me covid policia e ka obligim me i vizituar se a janë duke i respektuar masat.

**Hyriete Isufi** thekson:- a mundet taskforca e arsimit me vendosur për ndonjë hap të më tutjeshëm sepse ora është katërdhjetë e pesë minuta dhe mendoj që është gjatë pa marr ajër dhe do të ishte mirë me ndryshuar orën deri sa të kalon pak për shkak se ne e dimë se më shumë se dy javë nuk zgjatë. Është bërë një shpallje se nëse je i vaksinuar me tre vaksina nuk ke nevojë për izolim.

**Nora Xhoni** thekson:- u potencua se pesëdhjetë persona janë të infektuar me korona virus dhe ky numër a është i kategorizuar, te mësimdhënësit dhe nxënësit për shkak se baza e shpërndarjes është aty.

**Sherif Berisha** thekson:- ju keni bashkëpunim me stacionin e policisë dhe në këtë drejtim është mirë me vepruar sepse nëse një person që është me virus është mirë me qëndruar në shtëpi në mënyrë që të ruhet shëndeti i të tjerëve.

**Kimete Kuka -Hasallari** thekson:- takim me taskforcën zakonisht kemi për çdo javë dhe në takimin e ardhshëm që do ta kemi do ta elaborojmë dhe t'i marrim masat e duhura sepse shumica e moshës së re janë të infektuar, zakonisht nxënësit, kemi bërë përpjekje me drejtorët e shkollave që të vaksinohen por është dashur të epet deklaratë nga prindërit dhe prindërit kanë hezituat të vaksinohen fëmijët dhe ja ku e kemi situatën. Të gjithë nxënësit të cilët kanë dal pozitiv nuk janë të vaksinuar. Me policinë kemi në vazhdimësi kontakte dhe në takim të cilat do ti kemi do ti rekomandojmë për me i ndërmarr gjitha masat.

**Hanumshahe Dibrani** thekson:- sa i përket vaksinës edhe ata të cilët janë me dy doza të vaksinuara po infektohen dhe do të ishte mirë që në afat dhjetë ditore me ndërprerë mësimin që besoj që do të ishte mirë edhe për nxënësit dhe për mësimdhënësit.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- nesër kemi takimin e tskforcës komunal në të cilën mund të merren vendime për shkak se është kompetencë e tyre. Do të kemi edhe takimin me KKSb-në në të cilin do t'i diskutojmë të gjitha çështjet të cilat u potencuan. Bashkëpunim kemi me policinë por është pak hendikep për shkak të inspektoratit sanitare i cili ka kaluar me Agjensionin e Ushqimit dhe Veterinarisë në zyrën regjionale në Ferizaj për lëshimin e vendimeve për izolim dhe lëshimin e vendimeve nga izolimi që kjo po na paraqet problem për shkak se informacionet po na i dërgojnë me vonesë . Çështjen e orarit e diskutuam në mbledhjen e kaluar të taskforcë dhe mbetet në diskrecion të vetë taskforcës dhe drejtorëve të shkollave që të analizojnë me gjendje. Shkurtimi i orarit ndoshta nuk do të kishte ndonjë efekt por më mirë do të ishte me ndërprerë mësimin për dhjet ditë por kjo duhet të bëhet në dakordim me Ministrinë e Arsimit.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

### **3. Plani i punës së kryetarit të komunës për vitin 2022.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- në material janë paraqitur objektivat dhe planifikimet tona të cilat janë për vitin 2022 në të cilat jemi bazuar në projeksionet buxhetore në buxhetin i cili është miratuar nga viti i kaluar dhe do të mundohemi që së paku të ja përshtatim kërkesave të qytetarëve që na e kemi pasur në programin tonë qeverisës . Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë pyetje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Nora Xhoni** thekson:- në drejtorinë e arsimit nuk e hasa javën kulturore të qershorit dhe ditët e diasporës. A planifikoni me i mbajtur apo keni vendosur me i larguar këto aktivitete.

**Qamush Brava** thekson:- disa gabime të cilat janë bërë nuk duhet të kaloj por unë mendoj që ky material është mirë të kthehet prapë. Faqe numër një është shënuar plani i punës së kryetarit të komunës por duhet të jetë plani i punës së ekzekutivit sepse ndarja e pushtetit në nivel lokal bëhet në legjislativ dhe ekzekutiv sepse ekzekutivi i përfshinë edhe drejtoritë. Numri i protokollit nuk është, as numri rendorë nuk ju ka dhënë . Faqe numër dy përmbajtja numër katërbëdhjetë është shënuar kontrata për furnizim , pastaj është shënuar zyra e prokurimit dhe duhet të jetë zyra e prokurimit , kontrata për furnizim , kontrata për punë dhe kontrata për shërbime .

**Mehmet Ballazhi** thekson:- java kulturore nuk është anuluar sepse e dimë si ka funksionuar dhe ju e dini kur kam qenë anëtarë i kuvendit të komunës të planifikimet buxhetore kam kërkuar që të arsimi, kultura dhe sporti të bëhet një planifikim buxhetor i përgjithshëm vjetorë dhe jo mi bazuar sipas buxhetit që me i përshtatur aktivitetet. Ky është plan i kryetarit të komunës i cili e përfaqëson ekzekutivin e komunës në këtë aspekt dhe jo për ndonjë arsye tjetër. Shkresa e planit të cilën e kemi përcjell është e protokolluar. Sa i përket kontratave që u potencuan nuk ka ndonjë problem për shkak se ata hyjnë te prokurimi.

**Qamush Brava** thekson:- te objektivat e kryetarit të komunës e keni paraqitur një objektiv dy herë trajtimi i barabartë në ofrimin e shërbimeve sociale dhe skemës sociale, ndërsa te drejtoria e shëndetësisë nuk përmendet. Te drejtoria e financave te objektivat është paraparë përgatitja e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale (KABK) 2022-2024 në afatin ligjor sipas Qarkorës Buxhetore të MF-së dhe duhet të jetë 2023-2025. Hartimi i buxhetit komunal për vitin 2022 dhe parashikimet për vitet 2023 dhe 2024 por duhet të jetë 2023 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2024-2025. Drejtoritë kanë shkuar kopi pastë. Faqe 36 mbajtja e takimeve me drejtoritë për përcaktimin e prioritetëve për buxhetin e periudhës kohore 2022-2024, por duhet të jetë 2023 -2025. Përgatitja e Projekt Buxhetit për vitin 2022-2024, sipas Qarkoreve Buxhetore të lëshuara nga MF-ja, si dhe miratimi i tij deri me datën 30 shtator 2022, por duhet të jetë 2023-2025.

**Lindita Ballazhi** thekson:- gabimet teknike do të përmirësohen, ndërsa atë që e potencove kopi pastë aktivitete, planet të cilat janë në kuadër të drejtorisë së financave nuk mund të ndryshohen dhe nuk janë kopi pastë prej ish drejtorit por janë plane dhe objektiva që jo vetëm komuna jonë por gjitha komunat që duhet ti realizojnë.

**Qamush Brava** thekson:-faqe 40 plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2022, ky tabelar është marr kur është miratuar buxheti në vitin 2021 por tabelari duhet të ndryshohet se buxheti kur është miratuar është dërguar në parlament dhe pasi të miratohet vjen si Ligj dhe ky tabelar që është shënuar bien dhe duhet të shikohet ligji. Kjo tregon se nuk e keni marr nga Ligji që është miratuar në Kuvendin e Kosovës me numër rendorë 03L-06 për ndarjet buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2022 dhe ati shihet se ka një dallim në këtë tabelarë. Me ligj të buxhetit është edhe kategoria rezervë në shumë prej 15000€ që ju në këtë tabelë nuk e keni. Në këtë tabelarë e keni shifrën 470 000 €, ndërsa me ligj të buxhetit është 455 000 € dhe tabelari duhet të jetë 455 000 €.

**Lindita Ballazhi** thekson:- e kemi paraqitur këtë tabelë për planet e ndarjeve të shpenzimeve buxhetore në të cilën ky buxhet është miratuar nga ish qeverisja në muajin shtatorë të vitit 2021 dhe këtu është ndarja e të gjitha shpenzimeve komunale për vitin 2022 që do të thotë këto janë planifikime nga ish drejtori për buxhet dhe financa.

**Qamush Brava** thekson:- data tridhjetë shtatorë e vitit 2021 është data kur duhet të miratohet buxheti pastaj përcillet në Qeveri dhe Qeveria e prezanton në Parlament të Kosovës dhe në momentin që miratohet bëhet Ligj që do të thotë që ne i kemi paraparë 470 000 € por janë pranuar 455 000 € dhe duhet ta harmonizoni. Faqe 49 te drejtoria për urbanizëm keni potencuar që investimet kapitale janë në shumë prej 295 000 €, ndërsa me ligj të buxhetit për vitin 2022 janë 290 000 €. Sa i përket projekteve janë në shumë 495 000 €, ndërsa me buxhet e keni 295 000 € që do të thotë ka një dallim të madh.

**Nexhmedin Daci** thekson:-sa i përket shumave jam bazuar në buxhetin e miratuar nga kuvendi i komunës. Te projekti i qendrës kulturore kemi një marrëveshje që shuma prej 200 000 € janë të parapara për vitin 2022, mirëpo do të shikohen dhe harmonizohen me Ligjin e Buxhetit.

**Qamush Brava** thekson:- faqe 53 te drejtoria për shërbime publike është shënuar bazuar në rregulloret në fuqi dhe në statutin e komunës së Hanit të Elezit neni 77, mirëpo neni 77 fletë për zyrën për integritet evropiane por neni 66 bënë fjalë për drejtorinë për shërbime publike. Sa i përket buxhetit te drejtoria për shërbime publike është shënuar 75000 € ndërsa me ligjin për buxhet 70000 €. Faqe 59 drejtoria e zhvillimit ekonomik si objektiv e ka paraqitur inkurajim dhe stimulim të sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë dhe mendojë që zhvillimi ekonomik nuk ka të bëjë me bujqësi dhe blegtori. Aktivitet numër nëntë në drejtorinë e zhvillimit ekonomik që është potencuar marrja e iniciativave për projekte që kanë për qëllim zbutjen e papunësisë, zbritje e papunësisë dhe zbritje e emigracionit. Si do ta zbuteni punësinë kur drejtoria për zhvillim ekonomik e ka buxhetin zero zero pra vetëm për paga dhe për mallra dhe shërbime. Vërejtje kam te grupi punues për shkak se është shënuar zyra e prokurimit dhe shënon emri i Avdush Bajramliu , kurse materialin e dërgon Xhevdet Bushi është mirë që të harmonizohet kjo. Prioritet te drejtoria e administratës është formimi i këshillave të fshatrave dhe është shënuar se do ta bëjmë planin e këshillave të fshatrave, mirëpo këshillat e fshatrave nuk kanë legjitimitet qe dy vite u ka skaduar mandati . Është dashur në mënyrë të detajuar të na tregoni se kur do t'i themeloni këshillat e fshatrave.

**Kryesuesi** thekson:- çështja e këshillave të fshatrave je dëshmitarë edhe ty sepse ka dy vite që duam me i bërë zgjedhjet për këshillat e fshatrave, mirëpo kjo për shkak të kovidit nuk na mundësohet dhe kovidit nuk po i dihet por duhet ta zgjidhim këtë problem me kalimin e kohës.

**Arsim Dernjani** thekson:- vërejtjet të cilat u paraqitën për drejtorinë e shërbimeve publike dhe emergjencë do të analizohen dhe do të përmirësohen nëse janë të nevojshme.

**Majlinda Kaloshi** thekson:- sa i përket inkurajimit dhe stimulim të sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë , ndoshta pa dashje i ke tejkaluar edhe dy pika para kësaj, formësim të ambientit për krijimin apo zgjerim të biznesit dhe njoftim dhe promovim të potencialeve të komunës në rajon. Unë mendoj që bujqësia dhe blegtoria ndikojnë shumë në zhvillimin e ekonomik . U potencua për zbritje e papunësisë dhe zbritje e emigracionit por kjo është rezultat që ne si drejtori i kemi pritshmëritë për këtë pjesë e cila ndërlihet me aktivitet të cilat i kemi planifikuar për marrjen e iniciativave për projektet të cilat kanë për qëllim zbutjen e papunësisë , pra është rezultat ajo të cilën e potencuat dhe nuk është aktivitet dhe drejtoria aktivitet të cilat ka me i ndërmarr për me zbutur papunësinë është krijimin e mundësisë apo ambientit për zhvillim të bizneseve të ndryshme për me fituar grante në mënyrë që me i arritur rezultatet e pritura .

**Natyra Kalisi** thekson:- sa i përket këshillave të fshatrave ne e dimë që nuk ka komision dhe kjo është dashur të bëhet qe dy vite por nuk e keni bërë. Te pika nëntë faqe njëzet e tetë shënon hartimi, planifikimi i planit të punës për Këshillin e Fshatrave por afati i themelimit është në vazhdimësi. Pika njëzet e pesë që theksohet themelimi i këshillave të fshatrave dhe kjo potencohet si pikë në plan.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- sa i përket materialeve që janë përgatitur prej Avdush Bajramliu dhe u potencua që materiali është dërguar nga Xhevdet Bushi, mirëpo nga marrja e mandatit Xhevdet Bushika thuhet se ka qenë pak në punë për arsye të ndryshme në pushim vjetor, pushim mjekësorë por dikush është dashur me i bërë se me pas pritur shefin e prokurimit kishim mbetur shumë keq për materiale. Ajo është zyre prokurimit dhe Avdush Bajramliu e ka përgatitur materialin dhe është në rregull që përcillet në emër të shefit të prokurimit ashtu siç përcillet materiali në emër të kryetarit të komunës të cilin e hartojnë drejtoritë. Unë mendoj që nuk ka problem se kush i ka kryer punët dhe sigurisht është konsultuar me shefin prokurimit.

**Zaim Bela** thekson:- faqe katërdhjetë drejtoria e arsimit që është potencuar arsim dhe shkencë që janë 75 000€, pastaj shënon administrata e arsimit që përsëri është shuma e njëjtë 75 000 € është mirë të analizohet kjo. Është mirë që te drejtoria për bujqësi të planifikohet mbajtja e panairit me prodhime bujqësore për shkak se OJQ Labi ka investuar dhe është mirë që të shpërblehet një bujk që është ma i miri me prodhime.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- arsimi dhe shkenca i përfshinë të gjitha pastaj ndahet arsimi fillorë , çerdhja , administrata e arsimit të cilat janë veç e veç.

**Lindita Ballazhi** thekson:- arsimi dhe shkenca është shuma totale dhe më poshtë janë të gjitha të ndara.

**Abdurraman Bushi** thekson:- panairi i produkteve bujqësore është i paraparë dhe sipas kërkesave të cilat i kam nga bujqit e kam planifikuar me mbajtur në korrik.

**Sherif Berisha** thekson:- kodi buxhetorë në shumë prej 40 000 € te rruga “Isa Berisha” ju e dini që është miratuar edhe një kod buxhetorë prej Qeverisë në shumë prej 160 000 € dhe kërkoj që kjo të harmonizohet për shkak se kemi diskutuar me kryetarin e komunës që deri në muajin Qershor të kryhen të gjitha procedurat në mënyrë që të bëhet një projekt i mirë. Prej kompanisë “Sharrcem” ka ekzistuar një fond dhe kërkoj informacione më shumë nëse dikush mund të na jep se a ekziston ai fond, a ka komision , si ka vepruar më herët , a ka pasur llogari, a ka hyrë në buxhet të komunës, si është shpenzuar, kujt i kanë ndihmuar.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- kemi edhe një projekt shtesë prej Qeverisë që ka qenë iniciativa e deputetit të Lëvizjes Vetëvendosje z.Mirsad Shkreta dhe ne e kemi mirëpritur edhe pse ndoshta ish dashur paraprakisht me diskutuar me neve në përgjithësi që t’i harmonizojmë kërkesat me planet dhe objektivat që i kemi. Mjetet të cilat janë ndarë prej Qeverisë do të shpenzohen në kuadër të parkut të qytetit. Sa i përket fondit të kompanisë “Sharrcem” nuk kam pasur ndonjë takim konkretë për këtë çështje dhe gjatë bisedave formale që i kemi pasur me disa përfaqësues të kompanisë “Sharrcem” e kemi diskutuar . Aty ka qenë një bord i formuar që në fillim shumë e mjetëve të cilën e ka dhënë kompania “Sharrcem” ka qenë 60 000 € që do të thotë çdo 15 000 € në çdo tre muaj që janë investuar prej “Sharrcemit” deri në vitin 2016 dhe besoj që z.Qamush Brava duhet të jetë më i vëmendshëm kur të diskutojë për këtë çështje për shkak se ka informacione. Për shkak të pakënaqësisë që e ka pasur kompania “Sharrcem” për mjetet financiare që nuk janë dedikuar aty ku duhet e ka themeluar Labin në mënyrë që me i ndihmuar komunitetit me projekte të ndryshme sipas kërkesave të tyre . Nuk kam numra të saktë për fondin sa ka funksionuar por z.Qamush Brava mund të më ndihmojë për shkak se ka qenë kryesues i bordit. Informacione nuk i kishin se sa janë shpenzuar ë këtë bord por kanë premtuar që do ti sjellin në mënyrë që me pasur një pasqyrë të qartë se çka është dhënë prej kompanisë “Sharrcem”.

**Qamush Brava** thekson:- në këtë bord kam qenë në dy mandat dhe me një mandat ka qenë z.Menduh Vlashi pra nga viti 2014 dhe realisht marrëveshja “Sharrcem” – Komunë ka qenë që të investohen në katër periudha nga 15000 € që do të thotë 60 000 € por në realitet asnjë herë nuk i kanë dhënë 60 000 €. Në periudhën në të cilën kam filluar unë i kanë ndarë 30 000 € edhe pse marrëveshja ka qenë për 60 000 € . Më vonë ka ardhur duke i zbritur shifrat dhe katër vitet e fundit vetëm nga 15000 € i kanë ndarë brenda një viti.

**Sherif Berisha** thekson:- a ekziston mundësi që të specifikohen se ku do të shtrohen kubëzat e betonit dhe jo vetëm për kubëzat por çdo kund nuk specifikohen se ku do të shpenzohet ky buxhet. Te zyra e kryetarit të komunës janë të planifikuara 23 000 € për të cilat nuk kam asgjë kundër por është mirë që të dihen arsyeja e shpenzimeve në zyre të kryetarit të komunës.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- në momentin që do të miratohet buxheti i komunës për vitin 2023 do të jemi të kujdesshëm me planifikimet tona në mënyrë që t’i bëjmë më konkretisht sepse edhe auditorët kanë dhënë vërejtje për mos specifikim dhe ju e dini që është proces dhe nuk mundemi për një herë me i kryer sepse buxheti është i miratuar dhe janë disa projeksione që nuk mundemi me i lëvizur.

**Hyriete Isufi** thekson:- ne e dimë që kjo është vazhdimësi dhe çdo herë duhet të shkon vazhdimësi. Është paraparë vendosja e pajisjeve digjitale Ekioska ku është planifikuar të vendoset. Vendosja e tabelave digjitale në rrugën Adem Jashari si janë paraparë të vendosen . Deri ku kanë mbërri punët në shtëpinë e kulturës dhe çka parasheh faza e tretë . Drejtoria e arsimit ka paraparë mbështetjen dhe krijimin e kushteve për punë shtesë të nxënësve me talent të veçantë dhe avancimin e tyre dhe është mirë me dhënë ndonjë instruksion që me nisë dhe me punuar dhe nëse ka ndonjë shpërblim për nxënësit besoj që pak më ndrysh shihet. Në vizitë te shkolla kur ishit u përmendë vizita studimore e nxënësve për me i vizituar muze të ndryshëm dhe është mirë me i përfshirë në plan. Te organizimi i garave nuk ishin përfshirë garat në ping pong dhe shohë se te nxënësit ka një interesim dhe është mirë edhe ky sport mu përfshirë. Çdo herë po paraqitet problem çështja e kolonës që bëhet te kufiri te pjesa për me shkuar në drejtim të fshatit Seçishtë dhe te fshatrat tjerë të asaj ane është mirë me planifikuar për me bërë zgjidhje. Te drejtoria e bujqësisë është paraparë sensibilizimi i qytetarëve në shtimin e numrit të kërkesave për prerje të pyjeve private që të legalizohet transporti dhe a do të mundeni me u kujdesur se a janë prerë pyjet të cilat janë në emër të personave privatë apo në emër të shtetit. Te sektori i mbrojtjes a jeni duke menduar për qenët endacak me bërë ndonjë zgjidhje sepse është shumë problem.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- për Ekioskën ende nuk kemi caktuar ndonjë vend shumë të veçantë por duhet të jetë te objekti i komunës që me pasur qasje qytetarët nga jashtë. Tabelat digjitale do të jenë në hyrje të qytetit dhe ideja ishte edhe një në qendër me vendosur.

**Nexhmedin Daci** thekson:- sa i përketë qendrës kulturore në javën e cila shkojë e kemi përgatitur edhe paramasën për fazën finale afërsisht 268 000 € deri në përfundim. Me fazën e cila është në realizim e sipër përfundon afërsisht edhe një muaj , ndërsa faza e fundit është pajisja me karrika , me perde, ndriçimi dhe disa gjëra të cilat nuk janë paraparë në projektin fillestarë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- përmes drejtorit të arsimit jemi munduar me rënë në kontakt me disa organizata që me mundur me bashkëpunuar dhe në kuadër të këtyre aktiviteteve kemi llogaritur si punë shtesë për aktivitetet që kanë të bëjnë me arsimimin në përgjithësi. Vizitat studimore do të varen prej kërkesave që do të bëhen prej grupeve punuese të nxënësve, arsimtarëve, profesorëve të cilët do të shohim të arsyeshme me bërë ndonjë vizitë çoftë me nxënësit apo së bashku me arsimtarë dhe profesorë. Sa i përket pingpongut jemi bazuar në klubet të cilat janë ekzistuese duke filluar prej voleybollit, futbollit , mundjes për shkak se ekziston si klube por nëse ka kërkesa mundë ta bëjmë ping pongun. Sa i përket çështjes për te kufiri jemi duke mundur për një rrugë në bashkëpunim me kompaninë “Sharrcem” edhe pse nuk ka diçka konkretë për këtë por e kemi në nivel të diskutimeve përmes “Sharrcemit” për me dal te rrethi pastaj do ta shikojmë me plan zhvillimorë këtë çështje. Te kufiri është në fazë të shpronësimit një pjesë nga terminali në mënyrë që me u zgjeruar ajo pjesë për me mbetur një drejtim vetëm për kamionë. Kam diskutuar me disa veterinerë por edhe me z.Besnik Kalisi me të cilin kam diskutuar dhe ma ka propozuar një far plani por në detale ende nuk e ka sjellë por kam kërkuar që të jetë në harmoni me ligjin.

**Abdurraman Bushi** thekson:- sa i përket pyjeve private e kemi shpallur lajmërimin dhe kemi propozuar sensibilizimin për shkak se shpesh herë po ndodhë që qytetarët po i presin pyjet e veta private pa dokumentacion dhe po hasin problem me policinë. Për me i eliminuar ato probleme do ta sensibilizojmë këtë çështje që sa më shumë me i prerë në mënyrë legale.

**Kryesuesi** thekson:- ju falënderoj për të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet të cilat i potencuat sepse janë për të mirë. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 10 për, 5 kundër.

U MIRATUAR PLANI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2022

#### 4. Propozim vendimi për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2021-2022.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Resul Suma** thekson:- kryetari i komunës gjatë fushatës dhe bashkarishtë kemi premtuar që bursa kemi me dhënë edhe për studentët të cilët studiojnë jashtë Universitetit të Prishtinës pra për Universitetin Shtetërorë të Tetovës dhe Universitetin e Tiranës , mirëpo në propozim vendim në këtë vit nuk janë përfshirë dhe kërkoj sqarim për këtë çështje.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- unë kam dhënë si premtim që së paku do të mundohemi dhjetë bursa me i shtuar për me ju dedikuar studentëve të cilët janë jashtë Universitetit Publik të Kosovë dhe me i dedikuar për studentët të cilët studiojnë në Universitetin e Tetovës. Ju njoftoj se është një rregullore për ndarjen e bursave dhe duhet të bëhet plotësim ndryshimi i sajë në mënyrë që të kemi mundësi që me ju ndarë bursa edhe studentëve të cilët studiojnë në Universitetin e Tetovës, mirëpo në këtë vit nuk mund të bëhet për shkak se merr kohë plotësim ndryshimi i rregullores për shkak të procedurave që duhet të zhvillohen.

**Zaim Bela** thekson:- edhe ne jemi mundura me ju dhënë atyre studentëve të cilët studiojnë në Universitetin e Tetovës të cilën prej pa mundësive nuk kanë mundur me u regjistruar në Universitetin e Prishtinës , mirëpo po numrin e saktë nuk e dimë për shkak se jemi përcaktuar për tridhjetë studentë . Nëse nuk mbushet numri i aplikantëve për bursë a ekziston mundësia që kjo shumë me ju rritë studentëve të cilët aplikojnë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- shuma është e përcaktuar dhe nuk mund të bëjmë ndryshime dhe me sa më kujtohet në vitin 2020 kanë aplikuar njëzet e katër studentë dhe tjerët nuk kanë aplikuar dhe nuk është ndryshuar shuma , ndërsa sa i përket numrit do ta shohim mundësitë buxhetore në vitin e ardhshëm. Te prioritet deficitare është një konkretizimi te pika tre.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit njëzëri.

#### U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË PËR VITIN AKADMIK 2021-2022

#### 5. Caktimi i kriterëve për shpalljen e konkursit për tri komitetet konsultative të komunës së Hanit të Elezit.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Qamush Brava** thekson:- këtë çështje e kemi diskutuar në mandatin e kaluar sepse edhe një komitet është themeluar , komitetin për persona me aftësi të kufizuara për të cilin kemi diskutuar që kur të shpallet konkursi të shpallet edhe për komitet konsultativ. Arsyeja e themelimit edhe të këtij komiteti është se këto komitet fillojnë me mandatin e kryetarit të komunës dhe duhet ti shërbejnë edhe kuvendit edhe ekzekutivit në dhënie e mendimeve apo shërbimeve të ndryshme. Nëse themelohen këto tre komitet, komiteti për persona me aftësi të kufizuara do të jetë i mangët për shkak se me fillim të mandatit të komitete kanë me pasur trajnime dhe vizita të ndryshme me komunat e tjera. Nëse mendoni që bëhet ndonjë shkelje ligjore unë jam për atë që të shpallet konkursi dhe në këtë komitet nuk ka persona që ka konkurrencë dhe ne të rizgjidhen të njëjti por qëllimi është që edhe ai komitet të shkon dhe mbesin praktika që edhe komitet themelohet me ekzekutivin e ri.

**Kryesuesi** thekson:-sa i përket komitetit për persona me aftësi të kufizuara është komitet aktiv dhe ka mandat se është formuar në fund të viti 2019 dhe për këtë arsye propozim vendimin e kemi dërguar në këtë formë sepse udhëzimi administrativ për funksionim e komiteteve konsultative parasheh që mandati të jetë katër vjeçar.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- komitete konsultative janë me mandat katër vjeçar dhe nëse ne ja ndërpresim mandatin bëjmë shkelje ligjore.

**Qamush Brava** thekson:- ky komitet duhet të themelohet dhe i potencova arsyet që nuk ka konkurrencë përsëri të njëjtit persona do të zgjidhen. Pika tjetër është themelimi i panelit që do të thotë se ai panel a ka bazë për me bërë përzgjedhjen dhe mund të dakordohemi që i njëjti panel të bëjë rizgjedhje e atyre personave të cilët janë në atë komitet. Shkelje ligjore besoj që nuk ka se nëse të njëjtit pranohen nuk do të ketë ankesa.

**Kryesuesi** thekson:- komiteti është dhe ka mandat nuk është mirë me i shkarkuar ata anëtarë dhe përsëri me i emëruar se nuk ka nevojë dhe në momentin që i skadon mandati atëherë e keni të drejtën për me diskutuar për këtë çështje.

**Bajrush Laçi** thekson:- ky komitet është i themeluar dhe ka mandat edhe dy vite, është funksional dhe unë konsideroj që nuk kemi nevojë për me themeluar të njëjtin pasi që është, mirëpo pasi t'i skadon mandati duhet të zhvillohen procedurat për me u zgjedhur përsëri pavarësisht se a ka persona, apo a ka konkurrencë nuk duhet me paragjykuar këtë. Nuk kemi të drejtë të ja marrim mandatin për shkak se udhëzimi administrative e përcakton çështjen e marrjen së mandatit, pra mandatin e kanë dhe duhet të presim deri sa të përfundon.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit njëzëri.

#### **U MIRATUA ÇAKTIMI I KRITEREVE PËR SHPALLJEN E KONKURSIT PËR TRI KOMITETE KONSULTATIVE TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT**

##### **6. Themelimi i panelit (ad hok) përzgjedhës të anëtarëve të komiteteve konsultative në komunën e Hanit të Elezit.**

**Kryesuesi** thekson:- sa i përket këtij paneli paraprakisht jemi dakorduar në mbledhje të komitetit për politik e financa. Në këtë panel duhet që tri subjektet politike të propozojnë nga një anëtar të komisionit, një anëtar nga ekzekutivi i komunës dhe një anëtarë nga shoqëria civile. Në bazë të numrit të votave të cilët i kanë marr në zgjedhje partitë politike i bien që aleanca për ardhmërinë e Kosovës mos me pas anëtarë në komision por nuk do të thotë që nuk do të ketë përfaqësim. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Qamush Brava** thekson:- para katër viteve kur janë themeluar komitete konsultative ju kam dhënë hapësirë grupeve parlamentare për me vendosë dhe në momentin kur janë tre këshilltarë përcaktim vote nuk ka por jam i barabartë me çdo parti e cila i ka tre këshilltarë, kështu që nga shefat e grupeve parlamentare që të vendosin, ndërsa për ndryshe me vota nuk mundesh me vendosë sepse unë jam i barabartë me çdo subjekt politik i cili i ka tre këshilltarë. Nëse dëshironi me përfshirë opozitën është mirë por nëse nuk dëshironi me përfshirë i keni numrat dhe mundeni mi zgjedh nuk është problem.

**Kryesuesi** thekson:- këtë pikë të rendit të punës e kemi diskutuar dhe udhëzimi administrativ e përcakton që tri subjekte politik me pasur përfaqësues në këtë komision dhe e vetmja mënyrë për me zgjidhur këtë çështje është në bazë të numrit të votave dhe po që se do të kishte pasur aleanca vota më shumë do të kish pasur përfaqësim në këtë komision. Në këtë formë menduam me bërë zgjedhje , mirëpo nuk do të thotë që nuk do të keni përfaqësim.

**Qamush Brava** thekson:- unë kam dashur edhe kryetarin e komunës me pyetur se a ka marrëveshje me subjektet politike dhe realisht në intervistat që e kam dëgjuar kryetarin e komunës ka potencuar se kam marrëveshje me LDK-në dhe me LVV . Po që se i marrim disa praktika të tjera të komunave si asaj të Podujeve i cili potencon se ka marrëveshje mirëkuptimi PDK dhe LDK që do të thotë se marrëveshja e mirëkuptimit realisht është kualicion dhe si opozitë këtu e shohë vetëm aleancën e nëse nuk na përfshini në kualicion nuk është problem .

**Mehmet Ballazhi** thekson:- si opozitë kemi qenë tre këshilltarë nga PDK-ja dhe një këshilltarë e ka pasur Nisma për Kosovën por nuk na keni trajtuar siç duhet dhe ndoshta paske harruar por se nuk kemi qenë të përfaqësuar në këtë komision. Ju faleminderit që po mi përcjellshe intervistat por kur t'i përcjellësh të jesh i vëmendshëm se çka them. Nuk besoj që kam potencuar diku që kam marrëveshje por kam potencuar se nuk kam ndonjë kualicionë klasik por kam një bashkë qeverisje sepse nëse do të kisha një marrëveshje në asamble komunale do t'i kisha çdo herë dymbëdhjetë asamblistë dhe nuk i kam çdo herë dymbëdhjetë . Kompletë bashkëpunimin po mundohemi me bërë në interes të qytetarëve. Po ta rikujtojë edhe një herë që në komitet konsultative nuk kemi qenë të përfshirë dhe kemi qenë të anashkaluar.

**Nora Xhoni** thekson:- në komitet për politik e financa e kemi diskutuar dhe jemi dakorduar, mirëpo realisht ashtu e kap logjika dhe partitë të cilat kanë vota më shumë ne të përfshihen në komision, ndërsa në komitete kërkoj që të kemi përfaqësim mos të anashkalohehi.

**Qamush Brava** thekson:- të gjitha komisionet të cilat formohen në rregullore potencohet se reflektojnë përbërjen e etnive politike në kuvend dhe nuk flitet se kush ka vota më shumë dhe askund nuk flitet me përbërje të votave për shkak se deri sa kemi ardhur në kuvendë vota ka pasur vlerë ndërsa këtu ka ulësja në kuvend edhe pse znj. Nora Xhoni ndoshta mund të pajtohet por unë jo për shkak se nëse doni me na pasur në kuvend duhet të na përfaqësoni dhe të na jepni hapësirë që unë mendoj se ka. z.Mehmet Ballazhi potencojë në replikë dhe e lidhi me të kaluarën por i kam dhënë hapësirë që me grupet parlamentare për me biseduar dhe kërkojë që tu epet hapësirë grupeve parlamentare me dal me biseduar.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- unë jam në gjendje me anashkaluar partinë demokratike dhe mund të mos jemi hiq të përfshirë në këtë komision , mirëpo edhe atëherë kur është themeluar ky komision marrëveshja ka qenë për mu përfshirë në komitete konsultative e jo në komision përzgjedhës dhe është i njëjti rast ashtu siç potencojë znj. Nora Xhoni dhe u dakordumë që mos me qenë në komisioni përzgjedhës por kërkoj që të përfshihemi në komitet konsultative dhe pavarësisht marrëveshjes ne nuk u përfshimë. Pasi në komitet për politik e financa jeni dakorduar në këtë formë nuk ka asgjë të keq dhe nëse nuk përfshihen atëherë mundemi me diskutuar. Nëse doni mund të dalin shefat e grupeve parlamentare dhe ne ta diskutojnë dhe për mu si ekzekutiv në atë formë si do ta bini vendimin unë do të pajtohem nuk ka problem .

**Kryesuesi** thekson:- unë kam diskutuar me shefen e grupit parlamentarë të AAK-së për këtë çështje dhe nuk jam i interesuar me dal jashtë udhëzimit administrativ.

**Nora Xhoni** thekson:- ne jemi opozitë dhe nëse kryesuesi i kuvendit nuk do ta kishte përmendur përfaqësimin tonë nga jashtë do të isha revoltuar por çështjen e komisionit nuk e zura tragjike që pa tjetër të jetë përfaqësimi jonë dhe nuk shohë diçka të keqe.

**Kryesuesi** thekson:- nëse jeni në dakord u jap pesë minuta pushim për këtë çështje dhe shefat e grupeve parlamentare mund të bisedojnë.

**Sherif Berisha** thekson:- unë nuk jam që të dalim në pushim për shkak së në mbledhje të KPF-së të gjithë u dakorduar për me shkuar në këtë formë. Unë dua ta informojë z. Qamush Brava dhe opinionin se si Lëvizja Vetëvendosje nuk kemi kualicion as publik as të fshehtë por do të kontribuojmë aq sa dimë dhe aq sa mundemi në ato pika që e shohim që mund të bashkëpunojmë, për ndryshe jemi në opozitë dhe kush do që donë me bashkëpunuar prej opozitës dhe prej pozitës ne do të jemi mirënjohës

**Zaim Bela** thekson:- përfaqësuesin të cilin e kemi dërguar në KPF i dha sqarimet dhe nëse jeni dakorduar që me na përfaqësuar është mirë, ndërsa sa i përket anëtarit në komision pasi që keni vendosur në KPF pajtohem me propozimin të cilin e ka dhënë znj. Nora Xhoni. Ne jemi opozitë dhe po i shohim numrat por i kemi parë edhe në seancën inauguruese të kuvendit të komunës dhe lëvizja vetëvendosje i ka tre anëtarë dhe janë vetëm dy.

**Sherif Berisha** thekson:-publikisht e kemi shpjeguar këtë çështje dhe nuk kam qajap shpjegime këtu.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka ftoj grupet parlamentare që të japin propozimet e tyre.

**Ibadete Kalisi** thekson:- në emër të grupit parlamentarë të partisë demokratike propozoj z.Resul Suma për anëtarë të komisionit.

**Refet Kalisi** thekson:- në emër të grupit parlamentarë të lidhjes demokratike propozoj znj.Hanumshahe Dibrani.

**Sherif Berisha** thekson:- në emër të grupit parlamentarë të lëvizjes vetëvendosje propozoj znj.Ajnure Thaçi.

**Mehmet Ballazhi** thekson:-prej ekzekutivin ndërkohë do ta përcjellim emrin për anëtarë të komisionit në sekretari.

**Kryesuesi** thekson:- edhe shoqëria civile është dakorduar që anëtarin e komisionit do ta dërgojnë ndër kohë në sekretari. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit 13 për , 2 kundër .

U MIRATUA THEMELIMI I PANELIT AD HOK PËRZGJEDHËS TË KOMITETEVE KONSULTATIVE NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT

## **7. Informatë mbi veprimtarit e subjekteve afariste për vitin 2021.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Majlinda Kaloshi** thekson:- kemi rreth 201 subjektet tatim pagues , ndërsa 90 sosh janë biznese pasive. Gjatë vitit 2021 kemi pasur 30 kërkesa për regjistrim të bizneseve të reja, e nga këta kemi 17 biznese individuale 16 të tjera shoqëri me përgjegjësi të kufizuara . Për shuarje të bizneseve kemi pasur tri aplikime dhe kërkesa për ndryshime kemi pasur në total 59 kërkesa . Të hyrat vetanake që komuna inkason nga bizneset për vitin 2021 kemi pasur një shumë prej 75 783.89 €. Materialin keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Sherif Berisha** thekson:- për bizneset të cilat nuk janë të regjistruara dhe të cilat janë funksionale a do të ndërmerrni diçka , si do të veproni.

**Zaim Bela** thekson:- a dihet borxhi total sa është i këtyre bizneseve të cilat operojnë në komunën e Hanit të Elezit.

**Majlinda Kaloshi** thekson:- për bizneset e pa regjistruar e kemi një shifër por inspektorati është në teren duke i shikuar ata të cilët janë ilegale apo që nuk janë të regjistruara në komunë si veprimtari biznesore. Sa i përket borxheve 256 416.76 € dhe kemi filluar me ju shpërndarë fletë kujtesa bizneseve.

**Kryesuesi** thekson:-a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas rendit të punës.

#### **8. Formimi i komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale për mbeturina.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Arsim Dernjani** thekson:- komisionit të aksionarëve të më herhshëm i ka skaduar mandati kemi parashtruar propozim vendimin për me zgjedhë përbërjen e komisionit të aksionarëve. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Qamush Brava** thekson:- a ekziston ndonjë marrëveshje në mes grupeve parlamentare për këtë çështje.

**Kryesuesi** thekson:- marrëveshje nuk kemi por Ligji për Ndërmarrjet Publike e parasheh që dy anëtarë të jenë nga Kuvendi i Komunës dhe një nga ekzekutivi i komunës

**Qamush Brava** thekson:- pasi që z.Refet Kalisi ka qenë drejtor i shërbimeve publike dhe prej opozitës më adekuat se z.Refet Kalisi asnjë nuk jemi

**Refet Kalisi** thekson:- ju faleminderit po unë nuk pranojë me qenë në këtë komision ju lë radhën anëtarëve të kuvendit të komunës të cilët janë me moshë më të re.

**Nora Xhoni** thekson:- kërkoj nga shefat e grupeve parlamentare që të dalim pesë minuta pauzë dhe të dakordohemi për këtë çështje.

**Kryesuesi** thekson:- pasi që znj Nora Xhoni kërkoj që shefat e grupeve parlamentare të dalin pesë minuta pauzë dhe të dakordohemi e përkrah propozimin dhe jap pesë minuta pauzë. Pas konsultimeve që patën shefat e grupeve parlamentare ftojë të japin emrat për anëtarë të komisionit.

**Resul Suma** thekson:- në emër të grupit parlamentarë të partisë demokratike propozoj z.Xhevahir Dernjani për anëtarë të komisionit.

**Anure Thaçi** thekson:- në emër të grupit parlamentarë të lëvizjes vetëvendosje propozoj z.Sherif Berisha për anëtarë të komisionit.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- në emër të ekzekutivit propozoj znj.Sevime Bajrami për anëtare të komisionit.

**Refet Kalisi** thekson:-propozoj që komisioni i aksionarëve të kompensohet për shkak se i jep motiv për punë.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit 14 për , 1 abstenim..

**U MIRATUA FORMIMI I KOMISINIT KOMUNAL PËR AKSIONARËVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE PËR MBETURINA**

## 9. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Qamush Brava** thekson:- çdo herë vjetari në muajin janar na është shpërndarë dhe mjetet financiare janë kanë të destinuar nga mandati i kaluar . Kërkoj ta dijë deri ku kanë mbërri procedurat.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- sipas informacioneve që kam të planifikuara ishin mbi 800 vjetarë dhe është vjetarë për punën e kryetarit të cilën nuk e kam parë të arsyeshme. Sa isha anëtarë i kuvendit të komunës kam pas kritikë për vjetarin për shkak se afër 4000 € ka kushtuar dhe unë mendoj që këta mjete financiare është më mirë me i dedikuar diku tjetër sepse të gjitha ato informacione janë marr nga faqja zyrtare e komunës që unë mendoj që 80 % janë foto të kryetarit të komunës dhe pasi që nuk e kam parë që është një politik zhvillimore kam vendosur për mos me botuar.

**Qamush Brava** thekson:- që nga viti 2009 jam anëtarë në asamblenë komunal dhe vjetarët e çdo viti i kam të ruajtura sepse është puna jo vetëm e kryetarit të komunës por edhe ekzekutivit të komunës dhe çdo vendim që është miratuar në kuvendin e komunës është në vjetarë që do të thotë se në vjetarë është edhe puna e kuvendit të komunës e nuk është vetëm puna e kryetarit të komunës. Kjo praktikë nuk them që duhet të ndërpritet por duhet të vazhdohet edhe pse je zgjedhë kryetar i komunës vazhdoje. Në këtë mandat që jam nuk më pengon aktivitetet e juaj që do t'i paraqitnin në vjetarë sepse mendojë që është praktikë e mirë dhe mos ta humbim këtë praktik . Për vjetarin mjetet financiare janë të planifikuara dhe është gabim i madh nëse nuk na shpërndahet. Nëse ju duke që janë ekzemplarë shumë mund të shtypni një numër më të vogël.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- është mendimi i imi që unë kam vendosur që mos me botuar sepse kam menduar që ato mjete financiare kam menduar me i shfrytëzuar diku tjetër. Ju mund të mendoni që është mirë dhe të rekomandoni por unë e vlerësojë se a është mirë apo jo. Mjetet financiare konsideroj që do të shfrytëzohen diku tjetër dhe besoj që janë më të arsyeshme dhe ky është vendim që unë kam marr për mos me botuar.

**Qamush Brava** thekson:- kërkoj që të botohet edhe për vitin 2021 ndërsa për mandatin tuaj mund të mos e botoni dhe është mirë që ta botoni për vitin 2021 se unë llogarisë që kam bërë punë dhe ajo punë duhet të shihet në vjetarë. Mos na detyroni ne me mjete tona me financuar dhe me potencuar që ne e botuam vjetarin dhe kërkoj që mos të vjen deri aty.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- i nderuar këshilltarë tu kisha lutur që mos e fut në zemër atë mllef që e ki sepse jam duke u munduar me qenë shumë bashkëpunues dhe transparent në mënyrë që me krijuar praktika më transparente, më funksionale dhe është mendimi imë dhe duhet ta kuptoni që jemi në pluralizëm dhe ndërrimi i pushteteve ka politika tjera zhvillimore dhe politikat e mia janë në këtë drejtim pavarësisht që ty nuk pajtohesh. Unë pajtona me mos pajtimin tendë që ke drejtë mos me u pajtuar por politikat e mia janë që unë e kam parë të arsyeshme mos me botuar dhe kështu kam marr vendim dhe nuk jam duke bërë diçka diskriminuese për shkak se ato mjete i kam planifikuar me i orientuar diku tjetër që janë më të leverdishme.

**Qamush Brava** thekson:- kërkoj përgjigje me shkrim për objektin e biznesit që është lejuar me vepruar në parkun e komunës. Se çfarë leje ju ka dhënë , cila drejtori e ka lëshuar lejen , a janë zhvilluar procedurat e shfrytëzimit të pronës publike , a është marr taksa komunale dhe nga kush është shfrytëzuar. Kërkoj përgjigje me shkrim nga drejtorja për shërbime publike për dekorimin e qytetit për festat e fund vitit kërkoj të më prezantohet leja e hapësirës së shfrytëzimit të hapësirës publike. Në drejtorin e arsimit është bërë një transfer prej paraleles në qendër për arsimtaren znj.Erblina Dernjani si është bërë transferi, kurse me sa jam informuar , kërkesa për transfer kanë qenë edhe dy të tjera. Me ligjin për arsim nëse një transfer kërkohet nuk ka nevojë me bërë konkurs të brendshëm , në qoftë se dy e më shumë transfere duhet të bëhet konkurs i brendshëm, andaj mendojë se është shkelje ligjore dhe a duhet të njoftohet inspektorati i arsimit për shkak se unë mendoj se është shkelje e rëndë për shkak se tri kërkesa janë parashtruar. Mjetet financiare janë ndarë në qarkoren buxhetore 2022 /01 nga granti i arsimit 24330 € për shpenzimet e shujtave ditore për nxënësit nga

klasa e parë deri në klasën e pestë për komunën e Hanit të Elezit. Kërkoj përgjigje me shkrimë se ku do të fillon Drejtoria e Arsimit me ndarjen e shujtave për nxënës nga klasa e parë deri në të pestën. Ditëve të fundit shumë punëtorë të komunës kanë marr vërejtje, duke filluar nga z.Sadik Brava , Rraman Bushi, Xhevdet Bushi dhe dje është shkarkuar edhe kryeshefi ekzekutiv i ndërmarrjes NLP “Pastrimi” dhe flitet që radhën e ka drejtori i QKMF-së , mirëpo një këshill juridike e kam sepse vërejtjet të cilat janë dhënë nuk kanë këshillë juridike por ligji i procedurës civile 05L-031 neni një, dy, shtatë potencohet që përpilimi i aktit administrativ duhet të ketë këshill juridike. Nëse nuk epet këshilla juridik në ligjin e procedurës administrative parasheh afatin e ankesë nëntëdhjetë ditë , ndërsa nëse epet këshillë juridike afati i ankesës është tridhjetë ditë. Këtë problem e paraqita që vendimet që lëshohen pa këshilla juridike na lëshoni poshtë edhe neve si Han të Elezit por edhe si komunë, andaj ju preferoj që këshilla juridike mos mendoj që e anashkalon dike por vetëm i jep hapësirë dikund dhe është mirë që të epet këshilla juridike. Vërejtje keni filluar me dhënë por në kornizë ligjore ka shumë për drejtat e punëtorit dhe është problem me i larguar nga puna dhe keni praktika prej komunave kur janë pavarësuar në vitin 2000 kanë mbajtur persona nga dhjetë vjet në shtëpi dhe i kanë marr mjetet financiare tu nejtë, unë nuk dua ta shohë komunën time ashtu dhe për atë e paraqita këtë diskutim. Ne vetëm një procedurë e kemi zhvilluar ndaj z.Qamush Krasniqi që me armë zyrtare ka vrarë lepurin dhe ekzekutivi e ka transferuar në roje te objekti i komunës dhe me shkel ligj nuk i kam lënë, kështu që është mirë që t’i përmbahemi ligjit sepse kemi pasoja si komunë dhe i nderuar kryetar të thonë krejt mirë e ke a në fund barra te jetë tije.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- këta të cilat i potencove afër 90% të tyre i kemi marr nga kallëzo pik komi, prej rrjetit të OJQ-ve Avon net, prej Impos dhe është mirë që kur ti jepni informacionet ti jepni më të sakta . U potencua nga parafolësi që radhën për me shkarkuar e ka drejtori i QKMF-së dhe për atë potencova që mos të flitni me mllef por me argumente sepse drejtori i QKMF-së deri në fund të këtij muaji e ka mandatin dhe në momentin që i skadon mandati do të shohim se cilat veprime do t’i marrim sipas ligjit dhe rregullores pra duhet ta keni parasysh se nuk shkarkohet por i kalon mandati. Sa i përket shkarkimit të kryeshefit të kompanisë NPL “Pastrimi” është mirë që me ju drejtuar organit përgjegjës që e emron dhe e shkarkon sepse kuvendi nuk ka të bëjë me atë. Pra duhet të i drejtoheni bordit të kompanisë për shkak se unë kur ish anëtarë i kuvendit dhe kur kërkoja ndonjë informacion për bordet të cilat ju nuk keni dhënë asnjë herë informacion , ndërsa ne po japim informacione. Ne i dimë punësimet si janë bërë dhe ne nuk jemi te shkarkuar askënd dhe nuk jemi te larguar askënd prej pune dhe më i interesuar se ty jam për me ruajtur buxhetin e komunës për mos me na shkuar dëm për çështje të ankesave është dashur me pasus parasysh se si është ankesa dhe për çfarë është bërë ankesa që e përmende Sadik Brava dhe Rraman Bushi në mënyrë që të dihet se a ka pasur arsye apo nuk ka pasur dhe nuk është vetëm me përmend si ankesë pra duhet të dihet se cila ka qenë arsyeja e ankesës dhe praktikata e mia të zhvillimit të politikave këtu janë praktika të mia, dikush ndoshta është më i butë në veprime por ndoshta unë nuk jam dhe kjo është mënyra që unë mendoj me menaxhuar. Unë mendoj se nuk ka asnjë shkelje ligjore dhe po që se e kisha larguar nga puna është çështje tjetër është gjykata dhe ty nuk të vjen rendi me diskutuar në kuvend.

**Refet Kalisi** thekson:- për çfarë arsye është larguar kryeshefi i NPL “Pastrimi” sepse edhe ju ishit në opozitë por çdo herë lëvdata keni thurë për kompaninë i nderuar kryetarë sepse sa isha unë drejtorë kompania ka qenë në nivel. Unë mendoj që kryeshefi e ka një kontribut që ju nuk duhet me ja mohuar sepse unë i kuptoj politikat e juaja por është mirë që mos me marr vendime të ngutshme dhe nuk është mirë që të bëhet sikur në ish Jugosllavi që për një gjë u ndërmershin masa që ty ke qenë njëri që vetë ke pësuar prej atyre masave dhe unë mendoj që nuk ja ka vlejte me u shkarkuar kryeshefi i kompanisë NPL “Pastrimi”. Deri ku kanë mbërri punimet e nxemjes qendrore te objekti QKMF-së.

**Mehmet Ballazhi** thekson:-për çështje të kryeshefit të NPL "Pastrimi" është mirë që të konsultoheni dhe të kërkonti informacione nga bordi i kompanisë se cila ka qenë arsyeja se pse kanë marr vendim për me shkarkuar sepse nuk është çështje që më përket mu për me dhënë sqarim sepse nëse bordi ka të drejtë emërimi dhe ka drejtë shkarkimi për shkak se ligji e parasheh. Pavarësisht se si ju dukem i nderuar z Refet Kalisi unë nuk veprojë sipas praktikave të ish pushtetit Jugosllavë për shkak se ju e dini që unë kam qenë një luftarë i madh kundër pushtetit Jugosllave ju e dini shumë mirë dhe duhet ta keni parasysh por sinjerisht jam për me bashkëpunuar me gjithë secilin për mos me bërë shkelje ligjore për shkak se ne e dimë që janë bërë shkelje ligjore por nuk kam dashur me shkuar në prokurori apo në rrjete sociale sepse fundi fundit nga një herë edhe në ndërgjegje me mbetur mjafton.

**Sherif Berisha** thekson:- para objektit të postës të gjitha veturat e stafit komunal janë të parkuara dhe është mirë që të lëshohet një urdhëresë që ata vetura mos ta pengojnë trotuarin dhe parkingun për shkak se parkingun ekziston mbrapa objektit të komunës.

**Kimete Kuka -Hasallari** thekson:- sa i përket stomatologut është një ndër objektivat e planit të punës për këtë vit, por problemi qëndron tek numri i punëtorëve që është numër i kufizuar nga MSH, janë vetëm 32 punëtorë të lejuar ku edhe është numër i përmbushur në QKMF. Jemi në kontakte me Ministrinë e Shëndetësisë ku kërkojmë që të rritet numri i stafit sepse kemi mungesë dhe do t'u bëjmë presion të vazhdueshëm që të rritet numri i stafit e veçanërisht për stomatologun që është i paraparë edhe me statut të QKMF-së. Tek AMF-ja në fshatin Gorancë besoj që nga fillimi i javës së ardhshme do të bëhet funksionale sepse janë pranuar 2 mjek nga Ministria e Shëndetësisë dhe kemi staf së paku për 2 herë në javë të dërgojmë një mjek familjar. Sa i përket nxehjes qendrore kemi pas takim me kompaninë e cila e ka kontratë por ata kanë deklaruar që do t'i fillojnë punimet në momentin që do të alokohet buxheti ata do t'i fillojnë punimet.

**Xhevahir Dernjani** thekson:- deri më tani i dëgjova të gjitha diskutimet por në këtë seancë të kuvendit më shumë ke për z.Qamush Brava që pasi që është në gjeneratë me Kryetarin e Komunës mos ta thërret në emër por të drejtohet si kryetarë i komunës pasi që drejtoritë po na respektojnë. Sa i përket vërejtjeve apo propozimeve që u potencuan ata të cilat janë reale besoj që përmirësohen. Pasi që jemi në stinën e dimrit drejtoria për shërbime publike ka bërë menaxhimin e situatave në tërë territorin e komunës së Hanit të Elezit.

**Zaim Bela** thekson:- edhe unë e falënderoj drejtorin e shërbimeve publike dhe kjo i bien që operacioni është i suksesshëm por personi vdiq dhe ato punë i ka barë së bashku me kryeshefin e kompanisë Pastrimi dhe në bazë të atyre punëve të cilat janë bërë të mirë kryeshefi i kompanisë kana shkarkuar. Unë nuk po të kuptojë se a është për lëvdata apo vetëm aj e ka neglizhuar punën se ato punë i kemi parë që janë bërë të mira dhe rrugët po shihen që po pastrohen dhe nuk kemi pasur ndonjë vërejtje.

**Hanumshahe Dibrani** thekson:- a do të ndërrohen dyert e hyrjes te shtëpia e kulturës.

**Sherif Berisha** thekson:-nëse pozita nuk mundet me na duruar lirisht mundte me dalë dhe na leni sallën neve dhe është mirë që krijohet hapësira dhe na i japim vlerësimet tona .

**Kryesuesi** thekson:- dyert te shtëpia e kulturës sipas informacioneve që kam do të ndërrohen. A keni edhe ndonjë diskutim, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në ora 14:13

Procesmbajtësi

Ayni Bushi

